

VENDIM
Nr. 446, datë 22.7.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR PËRMBYTJET DHE VËRSHIMET E UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për përmbytjet dhe vërshimet e ujërave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE GRANTI
MBI PËRMBYTJET DHE VËRSHIMET E UJËRAVE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË TURQISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (në vijim të referuara individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”) kanë rënë dakord për nenet vijuese:

Neni 1

Pala turke do të mundësojë dhurimin e pajisjeve të përfshira në aneksin 1, për të mbështetur Palën shqiptare në luftimin e përmbytjeve dhe vërshimeve të ujërave.

Neni 2

Granti i lëshuar në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, realizohet nga Pala turke si një gjest miqësie dhe vullneti të mirë, me qëllim mbështetjen e përpjekjeve të Palës shqiptare në luftën kundër përmbytjeve dhe vërshimeve.

Neni 3

Pajisjet që do të dhurohen, do t’i paraqiten Palës shqiptare brenda kuadrit të procedurave dhe parimeve të vendosura bashkërisht nga Palët.

Shpenzimet në lidhje me transferimin e pajisjeve të dhuruara për në Portin e Izmirit do të mbulohen nga Pala turke, dhe shpenzimet nga Porti i Izmirit për në Portin e Durrësit (duke përfshirë ngarkesën, ngarkimin dhe tarifat e tjera doganore) do të mbulohen nga Pala shqiptare.

Pala shqiptare do të garantojë lehtësimin e nevojshëm doganor dhe procedurat e tjera ligjore në lidhje me pajisjet që do të ofrohen, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

Neni 4

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi dhe interpretimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet konsultimit dhe bisedimit nëpërmjet Palëve.

Neni 5

Pajisjet që do të ofrohen do t'i përkasin Palët shqiptare, pas dorëzimit dhe do të përdoren nga Pala shqiptare në përpjekjet për të luftuar përmbytjet dhe vërshimet.

Neni 6

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të dokumentit përkatës.

Bërë në Tiranë, më 24.2.2021, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, turke dhe angleze, ku secili tekst është njëloj autentik. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Milva Ekonomi

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË TURQISË

Dr. Bekir Pakdemirli

Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë

ANEKS 1 LISTA E PAJISJEVE

Numri i makinerive pajisjeve që do të dhurohen	Firma	Modeli	Lloji	Viti i prodhimit
1	Fiat Kobelco	FD 30 C	Traktor zvarritës	2004
1	Agledozer	Blade	Për Fiat Kobelco FD 30 C	2004
1	Fiat Kobelco	FL 175	Ngarkues i gjurmuar	2004
1	Fiat Kobelco	W 130	Ngarkues me rrota	2004
2	Hitachi	EX 220 LC-5	Ekskavator me zinxhirë (me gropë-prapa)	2002
4	ABS		Pompë zhytëse portabël	2000